



Republika e Kosovës-  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije  
National Qualification Authority

Numër: 57/12

Datë: 04.09.2012

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve bazuar në nenin 4 me pikat 1,3,6,9 dhe nenit 5 të pikave 1,2,3 të Rregullores së punës për Këshillin Drejtues të AKK-së, si dhe në mbështetje të nenit 14, 15, 16, 17 të kësaj rregullore, si dhe duke u mbështetur në Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (nr. 03- L 0600), neni 10, neni 21.3 neni 22, si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2011, miratuar nga MASHT mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, duke u bazuar në nenin 17 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, (22.03.2011) si dhe në Vendimin e Këshillit Drejtues të AKK të datës 30. 03. 2012, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar i Kualifikimeve nxjerr:

### VENDIM

#### *Mbi ngritjen e tarifës për pagesën e ekspertëve të jashtëm*

- I. Tarifa e pagesës për një ditë pune të një ekspert të jetë tani e tutje 100 euro.

#### Arsyetim

Duke marrë parasysh që në Udhëzimin Administrativ të miratuar në shkurt të 2011 nga MASHT mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nuk është e përcaktuar shuma apo tarifa për pagesën e ekspertëve të jashtëm, Këshilli Drejtues i AKK përcakton këtë shumë/tarifë për ditë pune për ekspertë të jashtëm. Arsyetimi për këtë vendim mbështetet në faktin se buxheti i aprovuar i AKK nga Qeveria e Kosovës për vitin 2012 është 284,38. 50 euro, ndërsa për kategorinë Mallra dhe Shërbime është 224,006 euro ku përfshihen edhe këto shpenzime. Po ashtu kjo ngritje e tarifës nga 80 euro për ditë në shumën 100 euro për ditë bëhet me qëllim të nxitjes dhe aplikimit të ekspertëve profesional duke ndikuar drejtpërdrejt në vlerësime cilësore dhe profesionale për ofruesit e AAP.

  
Kryetari i KD së  
AKK-së  
Ragip Gjoshi

